

RAPORTI VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA

NË VITIN
2019

KRIMET NGA
URREJTJA



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut,
përfaqësuar nga Kryetari prof. dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Uranija Pirovska

Autorë:

Sibel Amet
Sanja Barlakovska Velkov



**KOMITETI I
HELSEINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT**

Naum Naumovski Borçe 83
1000, Shkup
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469
Web: www.mhc.org.mk
E-mail: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

1. PËR PROJEKTIN	4
2. METODOLOGJIA	5
2.1 Monitorimi i mediave nacionale të shtypura dhe elektronike	5
2.2 Njoftim deri te Misioni i OSBE-së në Shkup për incidentet dhe krimet nga urrejtja	5
2.3 Mirëmbajtja e ueb faqes interaktive për paraqitjen e krimeve nga urrejtja	5
3. REZYME E GJETJEVE KRYESORE	6
3.1 Konteksti	6
3.2 Numri i incidenteve	6
3.3 Llojet e veprave penale	9
3.4 Incidente sipas lokacionit	10
3.5 Incidente sipas muajve	11
3.6 Incidente për shkak të motivimit të anshëm	11
3.7 Viktima dhe kryerës	12
3.8 Statusi i rasteve	12
4. AKTIVITETET E EKIPIT PROJEKTUES	14
4.1 Ndekja e mediave nacionale të shtypura dhe elektronike	14
4.2 Rishikimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të OSBE/ODIHR për krimet nga urrejtja dhe incidentet në rajonin e OSBE-së	14
4.3 Mirëmbajtja, përditësimi, dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.com	14
4.4 Përgatitja e informatorëve mujorë për gjendjen me krimet nga urrejtja në vend	14
4.5 Përgatitja, përkthimi dhe publikimi i raportit nga ndjekja e krimeve nga urrejtja për vitin 2019	15
4.6 Shënimi i ditës të propozuar europiane për viktimat e veprave nga urrejtja (22 korrik) përmes organizimit të konferencave për shtyp dhe ngjarja “Turlitavë”	15
4.7 Ndarja e gjetjeve nga Raporti i monitorimit për vitin 2018 me institucionet që mund të kenë interes për të	15
4.8 Organizimi i konferencës për shtyp prë ndarjen e gjetjeve nga Raporti vjetor	15
4.9 Përfshirja e informacioneve për krimet nga urrejtja në raportet mujore të KMH në aspekt të situatës me të drejtat e njeriut në vend	15
5. PËRFUNDIME	16
6. REKOMANDIME	17
ANEKSI	18

1. PËR PROJEKTIN

Ky raport është rezultat i projektit “Avancimi i të drejtave të njeriut”, i cili ishte mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup, kurse është realizuar në periudhën prej 1 janarit deri në 31 dhjetor të vitit 2019.

Projekti kishte për qëllim që të merret me çështjen për veprat nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes përmes legjislacionit të avancuar, ngritjes të vetëdijes publike, ndërtimit të kapaciteteve dhe regjistrimit të incidenteve të kryera nga urrejtja. Më konkretisht, ky raport është dedikuar që të shërbejë si tregues për shtrirjen, natyrën dhe shpeshhtësinë e veprave penale nga urrejtja të kryera në vend.

Në kuadër të mandatit të tij si partner implementues i projektit, **Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut (KMH)** i realizoi aktivitetet e ardhshme në raport me krimet nga urrejtja, dhe atë:

1. Ndjekja e incidenteve/krimeve nga urrejtja me kujdes të veçantë të dhuna në sport e motivuar nga anshmëria dhe dhuna nga bashkëmoshatarët me motiv të anshëm ndërmjet personave të rinj;
2. Rishqyrtimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të ODIHR për krime nga urrejtja dhe incidente në rajonin e OSBE-së për vitin 2018;
3. Mirëmbajtja, përditësimi dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.com, duke përfshirë edhe futjen e informacioneve në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze, publikimin e vegëzave nga portalet e njohura të internetit, si dhe mirëmbajtjen e grupeve në Facebook dhe Twitter, kontrollimi i informacioneve për incidentet e regjistruara (Kërkesa për informacione deri te MPB dhe PP)
4. Përdorimi i aplikacionit Red Button në faqen e internetit të MPB-së dhe paraqitja e rasteve përmes të njëjtës;
5. Vendosja e bashkëpunimit të rregullt dhe të vazhdueshëm me MPB dhe PThP;
6. Prezantimi i punës të KMH në pjesën e kriminalitetit nga urrejtja përmes 5 punëtorëve për të rinj të fokusuar në rritjen e vetëdijes publike dhe ngritjes të kapaciteteve për parandalimin e veprave nga urrejtja, të organizuara nga Misioni i OSBE-së;
7. Përgatitja e informatorëve mujorë mbi gjendjen me krimet nga urrejtja në vend;
8. Përgatitja, përkthimi dhe publikimi i raportit për ndjekjen e krimeve nga urrejtja për vitin 2018 në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze;
9. Shënimi i Ditës të propozuar për viktimat nga urrejtja (22 korrik) përmes organizimit të konferencës për shtyp dhe ngarjes “Turlitava”;
10. Mundësimi i ndihmës juridike pa pagesë dhe këshillimi i viktimave të veprave nga urrejtja si dhe ndjekja e procedurave gjyqësore për rastet konkrete të cilat i referohen karakteristikave të ndryshme mbrojtëse. Në pajtim me Misionin e OSBE-së, Komiteti kontribuoi me shpenzimet e tij për projektin përmes realizimit të aktiviteteve në vijim:
11. Ndarja e gjetjeve nga Raporti i monitorimit për vitin 2018 me institucionet (MPB, Ministria e drejtësisë, PP, kontakti nacional për vepra nga urrejtja) të cilat do të mund të kishin interes për një gjë të tillë;
12. Organizimi i konferencës për shtyp për ndarjen e gjetjeve nga raporti vjetor; dhe
13. Përfshirja e informacioneve për krimet nga urrejtja në raportet mujore të KMH në aspekt të situatës të të drejtave të njeriut në vend.

2. METODOLOGJIA

2.1 Monitorimi i mediave nationale të shtypyra dhe elektronike

KMH monitoroi disa gazeta ditore me prirje ideologjike dhe përkatësi politike të ndryshme. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në nivel ditor, përmes dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk и www.grid.mk), si dhe përmes përdorimit të opsioneve për kërkim të avancuar nën rubrikën “Lajme” në www.google.com. Pasi të vërehej vepra apo incidenti nga urrejtja, KMH e shënonte titullin e stories (lajmit) dhe vegëzën respektivisht lidhjen në internet, me çrast vijonte drejtë publikimit të tij në portalin e internetit për paraqitjen e veprave nga urrejtja www.zlostorstvaodomraza.mk (shih aktivitetin 2.3 më poshtë). Si rezultat i realizimit të këtij aktiviteti, në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2019, KMH arriti që të shkruaj dhe të publikojë 159 vepra nga urrejtja/incidente.

2.2 Njoftim deri te Misioni i OSBE-së në Shkup për incidentet dhe krimet nga urrejtja

Detajet në lidhje me incidentet (përshkrim i shkurtër, data, koha dhe vendi, burimi i informacioneve, viktimat e përfshira, kryerësit, statusi i rastit, përgjigje e organeve kompetente, ndikimi mbi viktimat dhe mbi komunitetin) ishin bashkangjitur vazhdimisht në Misionin e OSBE-së në Shkup, dhe drejtë paraqitjes të tyre më të lehtë kontribuoi në masë të madhe funksionimi me sukses i mëtutjeshëm i ueb-platformës të krimeve nga urrejtja. Përveç asaj që incidentet e krimeve nga urrejtja mund të ndiqen në internet pasi ata të kryeshin, Misioni i OSBE-së në Shkup pranoi edhe një raport të përkohshëm dhe një raport përfundimtar, të përgatitur nga KMH. Ky raport përfundimtar do të ndahet me OSBE/ODIHR për raportin e tyre përfundimtar për krimet nga urrejtja të vendeve pjesëmarrëse në OSBE.

2.3 Mirëmbajtja e ueb faqes interaktive për paraqitjen e krimeve nga urrejtja

Ueb portali www.zlostorstvaodomraza.com (nga viti 2014 gjithashtu në dispozicion edhe nën www.zlostorstvaodomraza.mk) paraqet një vegël ndërvepruese e cila u mundësoi qytetarëve të pranojnë informacione dhe të paraqesin vepra nga urrejtja. Ai përmban hartë ndërvepruese e cila e tregon lokacionin e saktë ose të përafërt të incidenteve. Në faqen kryesore janë të shënuara kategoritë e veprave nga urrejtja dhe motivet e anshme, ajo siguron informacione në aspekt të mënyrës në të cilën qytetarët mund të paraqesin (e-aplikacione, Twitter, posta elektronike, dhe formulari elektronik), dhe në të janë të paraqitura grafikonët statistikorë. Gjithashtu ka edhe rubrika që i dedikohen pyetjeve të shtruar më shpesh, materiale dhe fjalor i ueb portalit, në kuadër të të cilave mund të gjenden informacione në aspekt të projektit, rëndësisë dhe shtrirjes të veprave nga urrejtja, si dhe publikime për krimet nga urrejtja. Përveç në gjuhën maqedonase, faqja është në dispozicion dhe ripërtrihet dhe përditësohet edhe në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. REZYME E


GJETJEVE KRYESORE

3.1 Konteksti

Në raportin e Komisionit European për vitin 2019 për përparimin e shtetit, theksohet se “me ndryshimet e Kodit penal të miratuara në dhjetor të vitit 2018 janë qartësuar dispozitat për krimet nga urrejtja dhe janë zgjeruar bazat mbrojtëse. Prokuroria publike u bë proaktive në fillimin e hetimeve për pretendimet për gjuhë të urrejtjes. Grumbullimi i të dhënave për gjuhën e urrejtjes nuk është sistematik, përdersia në bazën e të dhënave të shoqërisë civile është vërejtur rritje e rasteve të gjuhës të urrejtjes.” Analiza e veçantë e veprave nga urrejtja të regjistruara në vitin 2013, si dhe raportet vjetore për krimin nga urrejtja në vend për vitet 2014-2018, ku ky raport dhe ueb portali për paraqitjen e veprave nga urrejtja, www.zlostorstvaodomraza.mk, paraqesin përpjekjet e para dhe më gjithëpërfshirëse që të bëhet mapimi, monitorimi, dhe paraqitja e incidenteve të veprave nga urrejtja në vend.

Për më tepër, duhet të theksohet në këtë raport se edhe krahas asaj që ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal të votuara në dhjetor të vitit 2018, në mënyrë të qartë e përkufizojnë krimin nga urrejtja, në praktikë, njohja e duhur dhe në kohë dhe regjistrimi i veprave penale nga urrejtja nga ana e nëpunësve policorë dhe prokurorisë publike ende mungon, respektivisht është në nivel jo të kënaqshëm. Megjithatë, vlen të përmendet fakti se në vitin 2018 ka rritje të incidenteve të regjistruara nga ana e MPB-së (gjithsej 33), në krahasim me periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2017, kur janë regjistruar gjithsej 7 incidente. Ky trend pritet që të vazhdojë edhe në lajmërimin e MPB-së edhe në vitin 2019.

3.2 Numri i incidenteve



Në periudhën prej 1 janari deri në 31 dhjetor 2019, KMH regjistroi gjithsej 159 incidente dhe vepra nga urrejtja. Incidentet janë regjistruar menjëherë pasi janë paraqitur nga ana e mediave apo Ministrisë të punëve të brendshme. Gjatë kësaj, nga numri i përgjithshëm i incidenteve të regjistruara, janë vërtetuar 33 incidente (20%), përdërisa 126 incidente (80%) mbesin të pavërtetuara. Si vepra të pavërtetuara nga urrejtja, në pjesën më të madhe mbesin ato incidente të cilat në pajtim me indikatorët tjerë (lokacioni, mënyra e kryerjes, involvimi i të miturve dhe gjimnazistëve e të ngajshme) ekziston besimi racional se janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktmës respektivisht kryerësit. Edhe krahas kërkesave tona të dërguara drejtë MPB-së për vërtetimin nëse përkatësia etnike si indikator është e pranishme te këto incidente dhe vepra, nuk e morëm një vendim të tillë.

Shumica e incidenteve janë vërtetuar përmes kontaktit të policisë, buletinëve policor dhe informimit medial. Incidentet e pavërtetuara janë gjithsesi të përfshira në raport, duke patur parasysh ekzistimin e indikatorëve të anshmërisë, duke përfshirë edhe: perceptimin viktimë/dëshmitar; komentet e dhëna në vendin e ngjarjes; dallimi ndërmjet viktimës dhe kryerësit në bazë etnike; formulari/shpeshmëria e incidenteve paraprake; natyra e dhunës; mungesa e motiveve tjera; dhe vendi dhe koha.

Më saktësisht, incidentet e pavërtetuara janë të përfshira për shkak të informacioneve të pranuar në aspekt të vendit të incidentit psh, fqinjësitë e përziera etnike dhe shkollat, linjat e autobusit të cilat i shfrytëzojnë anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, vendi ku veprat nga urrejtja kanë ndodhur në të kaluarën, etj.), lloji i incidentit (psh, grupa më e madhe e të miturve sulmon një apo më shumë viktimë pa provokim, rrahje grupore, sulmi në autobus apo në stacionin e autobusit, etj.) koha e incidentit (pas rrahjes paraprake si formë e urrejtjes, pas orëve mësimore, gjatë apo pas ngjarjes sportive, etj) dhe prona e dëmtuar gjatë kohës të incidentit (psh, vendi për ritet fetare). Incidentet e vërtetuara dhe të pavërtetuara mund të shihen ndaras në portalin e ueb faqes për paraqitjen e veprave nga urrejtja (të vërtetuarit janë të shënuara me sustën tekstuale të gjelbërt, përdërisa të pavërtetuarit me sustë tekstuale të kuqe.

Përkatësia etnike (135 incidente) dhe përkatësia politike (15 incidente) janë bazat më të përfaqësuara për shkak të të cilave janë kryer veprat nga urrejtja në vitin 2019, 2 incidente janë kryer për shkak të religjionit apo bindjes fetare si bazë, 2 incidente janë motivuar nga orientimi seksual i viktimave, 2 incidente janë motivuar për shkak të kombësisë të viktimave, 2 incidente për shkak të statusit të tij të migrantit/refugjatit dhe 1 incident i motivuar nga raca. 12 incidente e përmbushin figurën e veprës penale “Nxitja e urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarje apo mosdurim”.

Viktimat dhe kryerësit më shpesh janë persona të rinj, anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike (kryesisht maqedonas dhe shqiptarë). Më shpesh, një incident i përmbush figurat e dy apo më shumë vepra penale, prandaj edhe nga këto arsye numri i veprave penale nuk përputhet me numrin e incidenteve. Më shumë incidente të shkaktuara për shkak të përkatësisë apo bindjes politike nuk përfshijnë persona fizik si viktimë. Në vend të saj, si viktimë paraqiten persona juridik, që ka të bëjë edhe me faktin se pjesa më e madhe e këtyre incidenteve i referohen dëmtimit të pronës dhe shkaktimit të dëmit material.

Shumica e veprave penale të theksuara përshtijnë: Dhunën (115), Dëmtimi i pronës të huaj (16), Lëndimi trupor dhe lëndimi i rëndë trupor (16), Shkaktimi i urrejtjes nacionale, racore, apo fetare, përçarje apo mosdurim (12), Përhapje të materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik (2), Grabitje (2) dhe Rrezikimi i sigurisë (2).

Detajet në aspekt të incidenteve, siç janë përshkrimi i shkurtër, data, koha, vendi, burimi i informacioneve, viktimë/viktimat e përfshira, kryerësit, statusi i rastit, përgjigje nga ana e pushteteve, dhe ndikimi i viktimës/viktimave në komunitet mund të gjenden në Aneksin që titullohet “Incidentet e krimeve nga urrejtja në vitin 2019” të këtij raporti. Në aneksin e njëjtë, ka fushë për “indiktorët e anshmërisë”, që është inkorporuar në çdo incident të caktuar. Ai përfshin të dhëna për: perceptimin e viktimës/dëshmitarit; komente të bëra në vendngjarje; dallimi ndërmjet viktimës dhe kryerësit në baza etnike; formulari/shpeshmëria e incidenteve paraprake; natyra e dhunës; mungesa e motiveve tjera; dhe vendi dhe koha. Përveç sigurimit të informacioneve shtesë në aspekt të incidenteve, kjo pjesë është veçanërisht e dobishme për të kuptuar se pse incidentet e pavërtetuara janë gjithashtu të përfshira në këtë raport.

Në mars të vitit 2019, KMH e dërgoi Raportin e tij vjetor për veprat nga urrejtja për vitin 2018 deri te OSBE/ODIHR¹. KMH mbetet organizata e vetme joqeveritare e cila e informon OSBE/ODIHR për situatën me veprat nga urrejtja në vend.

Rritja e numrit të veprave nga urrejtja të regjistruara në vitin e kaluar, vazhdon edhe në vitin 2019. Për më tepër, janë shënuar trende të caktuara në raport me motivin e anshëm në bazë të të cilave janë kryer veprat nga urrejtja..

Me numrin prej vetëm 15 incidenteve të kryera për shkak të përkatësisë apo bindjes politike, mund të përfundohet se numri i incidenteve të motivuara nga përkatësia politike është ulur gjatë viteve. Trendi i zvogëlimit të numrit të këtyre incidenteve mund të jetë për shkak të procesit të zgjedhjes të më shumë çeshtjeve politike afatgjate të brendshme dhe të jashtme. Ky lloj i incidenteve, më së shpeshti i referohet dëmtimit të pronës të partive politike (kryesisht LDSM apo VMRO-DPMNE) apo dërgimit të kërcënimeve serioze ndaj anëtarëve dhe simpatizantëve të partive politike. Incidentet intensifikohen në janar menjëherë pas votimit të ndryshimeve të Kushtetutës me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes të Prespës të vitit 2018, si dhe në prill, para dhe gjatë zgjedhjeve presidenciale. Njëkohësisht është regjistruar incident edhe në fund të vitit, pas vendimit të partive politike për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2020. Megjithatë, serioziteti i këtyre incidenteve nuk është i krahasueshëm me ata që ishin regjistruar në vitet 2016, 2017 dhe 2018. Sigurisht që trendet e viteve të mëparshme përsëriten, nëse kihet parasysh se këto incidente ishin në rritje para dhe gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2014, zgjedhjet presidenciale në të njëjtin vit, zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016 si dhe zgjedhjet lokale në vitin 2017.

Trendi i dytë që është vërejtur i referohet numrit të incidenteve të kryera për shkak të prejardhjes etnike maqedonase apo shqiptare të kryerësit/viktimës. Në vitin 2013, këto incidente përbënin 84% nga të gjithë incidentet (98 nga 116), përdërisa në vitin 2014 përqindja ishte 61% (53 nga 87). Gjatë vitit 2015, vetëm 15 incidente (34%) kanë ndodhur ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, kurse në vitin 2016 kanë ndodhur 34 incidente (pothuajse 50%) ndërmjet këtyre dy bashkësive të ndryshme etnike. Në vitin 2017 nuk kishte zvogëlim domethënës të këtyre llojeve të incidenteve, edhe pse ata mbeten çeshtja më e ngutshme, duke patur parasysh se pjesa më e madhe e viktimave dhe kryerësve në këto incidente janë persona të mitur. Në vitin 2018, numri i incidenteve të regjistruara të kryera për shkak të prejardhjes etnike është rritur sërish në 58% (79 nga 123) nga të gjithë incidentet e regjistruara. Në vitin 2019, me 84,9% nga të gjithë incidentet e regjistruara (135 nga 159) për shkak të


1 <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>

prejardhjes etnike të viktimave/kryerësve, i bën këto incidente më të përfaqësuar dhe me intensitet shqetësues si në të kaluarën (2013/2014).

Pas disa viteve, në pjesën e parë të vitit 2019, janë regjistruar 2 incidente të caktuara të motivuara nga orientimi seksual/identiteti gjinor i viktimës. Potencialisht, kjo mund të nënkuptojë se për shkak të porosive pozitive dhe mbështetjes që e japin publikisht nga Qeveria dhe pjesë e figurave pozitive publike, besimi në institucionet e sistemit ngadalë ngadalë po ripërtrihet ndërmjet komunitetit LGBTI. Megjithatë, ky konstatim në asnjë moment nuk do të thotë se shoqëria është bërë tolerante ndaj komunitetit të LGBTI-së. Duhet të kihet parasysh se organet shtetërore ende nuk kanë patur sukses që në mënyrën e duhur të hetojnë incidentet e kryera ndaj komunitetit LGBTI në periudhën 2013 dhe 2014, kurse policia nuk pati sukses që të arrestojë asnjë nga kryerësit. Incidentet e regjistruara të motivuara nga orientimi seksual/identiteti gjinor në vitin 2019 kanë ndodhur gjatë kohës kur organizohej Marshi i parë i krenarisë në qershor në Shkup. Gjatë kësaj kohe, gjuha e urrejtjes dhe kërcënimet kundër LGBTI komunitetit ishin gjithnjë e më të pranishme.

Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal të cilat i referoheshin krimit nga urrejtja, e që u miratuan në dhjetor të vitit 2018, hyn në fuqi në 8 janar të vitit 2019. Ky është një ndryshim shumë domethënës në legjislacion dhe si rezultat duhet të tregojë rritje të ndjekjes penale për krimit nga urrejtja. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se ka rritje të incidenteve të regjistruara zyrtarisht nga ana e MPB-së, respektivisht në vitin 2018 janë regjistruar 33 vepra penale nga urrejtja nga ana e policisë, ndërsa në vitin 2017 nuk kishte incidente të raportuara, janë raportuar 2 incidente në vitin 2016 dhe 5 janë paraqitur në vitin 2015.² Në këtë drejtim, në pajtim me përgjigjet ndaj kërkesave për qasje deri te informacionet të dërguar në MBP, vërehet se për herë të parë stacionet policore në mënyrë eksplicite i kanë kualifikuar veprat penale si vepra nga urrejtja.

3.3 Llojet e veprave penale





Shumica e incidenteve janë kryer nga personat e rinj. Gjithashtu, është vërejtur një numër i madh i kryerësve të panjohur. Viktimat dhe kryerësit zakonisht janë anëtarë të grupeve të ndryshme etnike (maqedonas dhe shqiptarë). Incidentet e raportuara i përmbushin figurat e disa veprave penale të parapara në Kodin penal. Shumë nga veprat penale të theksuara përfshijnë: Dhunë (115), Dëmtimi i pronës të huaj (16), Lëndim trupor dhe lëndim të rëndë trupor (16), shkaktimi i urrejtjes nacionale,

² Shiko: <http://hatecrime.osce.org/north-macedonia>

racore dhe fetare, përçarje dhe mosdurim (12), shpërndarje e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik (2), Grabitje (2) dhe Rrezikimi i sigurisë (2).

Më shpesh, veprat penale të kryera në një incident e plotësojnë figurën e dy apo më shumë veprave penale të pretenduara, dhe rrjedhimisht edhe numri më i madh është i veprave sesa incidenteve të prezantuara në këtë kapitull.

3.4 Incidente sipas lokacionit




Numri më i madh i incidenteve - 136 (85,5%) janë regjistruar në Shkup dhe në komunat përreth. Në Tetovë janë regjistruar 6 incidente, 7 incidente në Kumanovë, 4 incidente në Gostivar, 2 incidente në Manastir dhe Strugë dhe 1 incident në Veles, Gjevgjeli, Ohër, Vevçan, Shtip, Vinicë, Resnjë dhe Makedonska Kamenicë. Ngjajshëm si në vitin 2018, numri i rritur i incidenteve në kryeqytet vazhdon edhe në vitin 2019. Incidentet në Shkup dhe në afërsi të tij i referohen sulmeve fizike ndërmjet anëtarëve të bashkësisë etnike shqiptare dhe maqedonase, si dhe dëmtimi i pronës të partive politike.

Edhe këtë vit, incidentet në Shkup dhe rethinë përfshijnë sulme ndërmjet anëtarëve të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare, si dhe dëmtim të pronës të partive politike. Në përqindje këto incidente më shumë janë të përfaqësuara në nivel të stacioneve policore në komunën Qendër me


22% dhe komunën Aerodrom me 18%, më tutje incidente të tilla janë regjistruar në territorin e stacioneve policore të Bit Pazarit 17%, Gazi Babës 14%, Çairit 10%, Karposhit dhe Gjorçes me 6,5%, Kisella Vodës me 4% dhe Saraj me 2%.

3.5 Incidente sipas muajve




Më shumë incidente janë kryer në Prill (26) dhe Maj (21). Janë regjistruar 17 incidente në nëntor dhe janar, 16 në qershor, 14 në mars, 11 në korrik dhe shtator, 10 në shkurt, 7 në gusht, 3 në dhjetor dhe 3 në tetor.

3.6 Incidente për shkak të motivimit të anshëm




Në vitin 2019, veprat nga urrejtja janë kryer për shkak të përkatësisë etnike (84,9%), përkatësisë politike (9,4%), statusi i migrantit/refugjatit (1,2%), religjioni dhe bindja politike (1,2%), kombësia (1,2%), orientimi seksual/identiteti gjinor (1,2%), dhe raca (0,9%). Shumica e incidenteve përfshijnë shqiptarët dhe maqedonasit si viktimë dhe kryerës.

3.7 Viktima dhe kryerës



Gjatë vitit, kishte të paktën 163 viktima (prej të cilëve 104 persona të mitur) dhe 358 kryerës (prej të cilëve 93 persona të mitur) të krimit nga urrejtja. Gjithmonë kur në media është raportuar për numër të padefinuar (psh. ndërmjet 10 dhe 15) kryerësisht për qëllimet e këtij raporti është shfrytëzuar vlera më e vogël. Gjithmonë kur është raportuar se “grupa” e kryerësve e kanë kryer veprën nga urrejtja, vlera e shfrytëzuar në këtë raport është 3 persona. Në të paktën 50% të 159 incidenteve, kryerësit kanë vepruar si grupë. Shumica e viktimave dhe kryerësve janë persona të rinj meshkuj.

3.8 Statusi i rasteve



Duke patur parasysh atë se nuk ekziston bazë e të dhënave për krimet nga urrejtja, rastet janë regjistruar përmes kontaktit me policinë, ndjekjen e mediave dhe informacionet e fituara drejtëpërdrejtë nga viktimat. Për çdo incident të regjistruar, KMH ka dërguar kërkesë për informacione deri te Ministria e punëve të brendshme që të marr informacion për statusin e rasteve.

Nga përgjigjet e fituara, është shënuar se MPB-ja filloi të regjistroj disa incidente në mënyrë eksplicite si vepra penale nga urrejtja (15 raste nga gjithsej 159). Në fakt, këto incidente i referohen rasteve të cilat përfshijnë kërcënimet kundër politikanëve përmes internetit dhe rastet e shpërndarjes të materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik. Megjithatë, në pjesën më të madhe, përgjigjet e fituara nga MPB-ja për incidentet në vitin 2019 ishin të pamjaftueshme dhe nuk ju përgjigjën pyetjeve në kërkesa, duke patur parasysh atë që nuk përmbanin informacione konkrete në lidhje me incidentin dhe vetëm informuan nëse ngjarja është regjistruar apo jo nga ana e MPB-së.

Nga përgjigjet e fituara mund të vërehet se MPB-ja ka identifikuar 126 kryerës nga gjithsej 358 të regjistruar, nën hetime janë 13 lëndë, ndërsa janë dorëzuar 29 kallzime penale. Nga ana e MPB-së, 32 raste janë regjistruar si kundërvajtje më shpesh kundër rendit dhe qetësisë publike, kurse në disa raste bëhet fjalë për urdhëra për kundërvajtje të kryer nga Ligji për pengimin e dhunës dhe sjelljes të pahijshme në ndeshjet sportive. Në rastet të cilat i referohen dëmtimit të pronës të huaj apo përdhosjes të varrit, në përgjigjet e saj, MPB-ja ka theksuar se bëhet fjalë për vepra penale të cilat ndiqen me padi private. Në 4 raste, të dëmtuarit kanë refuzuar të dorëzojnë kallzime respektivisht fletëparaqitje për incidentet. Sidoqoftë, statusi për 83 raste mbetet i panjohur, që paraqet 54% nga të gjithë rastet gjithsej.

4. AKTIVITETET E EKIPIT PROJEKTUES

4.1 Ndekja e mediave nacionale të shtypura dhe elektronike

KMH ndiqte një numër të madh të gazetave ditore me prirje ideologjike dhe bindje politike të ndryshme. Ndjekja e mediave elektronike bëhej në bazë ditore, përmes internet-gjeneratorëve më të njohur të lajmeve (www.time.mk i www.daily.mk), si dhe me shfrytëzimin e opsioneve të avancuara nën seksionin “Lajme” në www.google.com. Pasi që është shënuar një krim apo incident nga urrejtja, KMH e publikonte në ueb-portalin për paraqitjen e krimeve nga urrejtja – www.zlostorstvaodomraza.com (shih më poshtë aktivitetin 4.3). Duke realizuar këtë aktivitet, KMH ka regjistruar dhe publikuar 159 krime/incidente nga urrejtja në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2019.

4.2 Rishikimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të OSBE/ODIHR për krimet nga urrejtja dhe incidentet në rajonin e OSBE-së

Në mars të vitit 2019, Komiteti i Helsinkit e dërgoi Raportin e tij vjetor për veprat nga urrejtja për vitin 2018 deri te OSBE/ODIHR. Komiteti i Helsinkit mbetet organizata e vetme joqeveritare e cila e informon OSBE/ODIHR për situatën e veprave nga urrejtja në vend.

4.3 Mirëmbajtja, përditësimi, dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.com

Gjatë periudhës raportuese në portal janë vendosur 159 incidente. Raporti vjetor për veprat nga urrejtja në vitin 2018 është publikuar në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze nën seksionin “Materiale”. Të gjithë incidentet e regjistruara në vitin 2019 do të përkthehen në gjuhën shqipe dhe angleze dhe do të jenë në dispozicion në këto gjuhë në portal.

Ndërmjet 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2019, portali është vizituar më shumë se nga 12.896 vizitorë individual që gjeneron 33.882 hapje të faqes. Përveç portalit, edhe grupa në Facebook dhe llogaria në Twitter janë përditësuar rregullisht. Numri i ndjekësve në Facebook në vitin 2019 ishte 4845. Njëkohësisht, portali ishte promovuar dhe përmes publikimeve të sponsorizuara në Facebook që në mënyrë eksponenciale e ka rritur numrin e vizituesve të ueb faqes. Për të krahasuar, tabela e mëposhtme e tregon numrin e vizitave për periudhën ndërmjet viteve 2013 - 2018:

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Vizitues	1,752	11,971	13,694	6,541	8,649	4,690	12,896

4.4 Përgatitja e informatorëve mujorë për gjendjen me krimet nga urrejtja në vend

Gjatë periudhës projektuese KMH përgatiti dhe publikoi 12 informatorë mujorë. Në këtë mënyrë, përmes paraqitjes grafike të të dhënave, publikut i janë siguruar informacione për situatën me krimet

nga urrejtja në vend. Buletinët mujorë janë publikuar në ueb faqen e KMH, si dhe në faqen e Facebook Krime nga Urrejtja (Злосторства од омраза).

4.5 Përgatitja, përkthimi dhe publikimi i raportit nga ndjekja e krimeve nga urrejtja për vitin 2019

Ky është një aktivitet i vazhdueshëm i cili përfundoi me grumbullimin e përgjigjeve pas dorëzimit të kërkesave për informacione nga Ministria për punë të brendshme.

4.6 Shënimi i ditës të propozuar europiane për viktimat e veprave nga urrejtja (22 korrik) përmes organizimit të konferencave për shtyp dhe ngjarja “Turlitavë”

Konferenca për shtyp për promovim në 22 korrik, dita europiane për viktimat nga veprat e urrejtjes si dhe prezantimi i Raportit vjetor për vitin 2017 është organizuar në 20 korrik në hapësirat e KMH. Mediat ishin të pranishme në konferencën për shtyp dhe publikuan 22 shkrime në gjuhën maqedonase në lidhje me të. Për më tepër, KMH e organizoi ngjarjen “Turlitava 6” me qëllim të festimit të tolerancës dhe bashkëjetesës të qetë ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme në vend. Këtë vit, fokusi i ngjarjes ishte drejtuar kah toleranca dhe respektimi i anëtarëve nga komuniteti rom. Lajmërimi për ngjarjen është publikuar në faqen e internetit dhe në faqen në Facebook të Komitetit.

Ngjarja në Facebook përfshiu të shijuarit e ushqimit nga kuzhina tradicionale maqedonase, shqiptare, turke, rome, serbe, kroate, vllafe dhe boshnjake si dhe muzikë dhe socializim ndërmjet pjesëmarrësve me prejardhje të ndryshme etnike, orientim seksual dhe pengesa. Ngjarja e theksoi rëndësinë e trajtimit të barabartë të grupeve të ndryshme në shoqëri dhe domosdoshmërinë e koekzistimit të tyre.

4.7 Ndarja e gjetjeve nga Raporti i monitorimit për vitin 2018 me institucionet që mund të kenë interes për të

Kopja e shtypur nga Raporti vjetor për krimet nga urrejtja për vitin 2018 ishte ndarë me të gjithë institucionet dhe organizatat e përfshira. Gjithashtu, krahas kopjes të shtypur, edhe verzioni elektronik ishte ndarë përmes postës elektronike me pjesëmarrësit e 10 mediave.

4.8 Organizimi i konferencës për shtyp për ndarjen e gjetjeve nga Raporti vjetor

Ftesa për konferencën për shtyp ishte ndarë edhe në faqen e internetit dhe në faqen e Facebook të KMH.

4.9. Përfshirja e informacioneve për krimet nga urrejtja në raportet mujore të KMH në aspekt të situatës me të drejtat e njeriut në vend

Rubrika e veçantë për krimet nga urrejtja ishte përfshirë në kuadër të raporteve mujore në aspekt të situatës me të drejtat e njeriut në Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor të vitit 2019.

5. PËRFUNDIME

- Tendenca e rritjes të numrit të veprave nga urrejtja e shënuar në vitin 2018, vazhdoi edhe në vitin 2019;
- Është rritur numri i incidenteve të kryera në bazë të përkatësisë etnike dhe numri i incidenteve të tilla arrin shifrën alarmante prej 86% nga të gjithë incidentet e regjistruara, pothuajse të gjithë këto incidente kanë ndodhur ndërmjet anëtarëve të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare, por ata edhe më tutje mbesin shqetësuese duke patur parasysh se shumica dërrmuese e viktimave dhe kryerësve të atyre incidenteve janë të mitur/të rinj;
- Partitë politike vazhdojnë me nxitjen e gjuhës të urrejtjes përmes shfaqjeve të tyre publike gjatë fushatave parazgjedhore. Gjuha e urrejtjes gjithashtu në masë të madhe shfrytëzohet në rubrikat e parapara për komente në mediat elektronike të cilat gjenerojnë lajme politike;
- Ekziston zvogëlimi i numrit të incidenteve politike, por trendi nga dy vitet paraprake me këto lloj të incidenteve mbetet i njëjti edhe këtë vit;
- Krahas përkushtimit të Qeverisë në drejtim të rritjes të mbrojtjes të të drejtave të komunitetit LGBT, si dhe krahas përzgjedhjes të prokurorit të ri shtetëror, rastet e veprave nga urrejtja të kryera mbi komunitetin LGBTI në periudhën e viteve 2013-2015, akoma mbesin të pazgjidhura në prokurorinë publike;
- Ende është e paqartë nëse pushtetet e njohin dallimin ndërmjet veprave nga urrejtja dhe gjuhës të urrejtjes;
- Disa prej veprave nga urrejtja kryhen për shkak të hakmarrjes apo ndëshkimit, për shkak të incidentit paraprak ndërmjet rinisë shiptare dhe asaj maqedonase;
- Veprat e motivuara nga anshmëria ende nuk janë të hetuara siç duhet nga ana e policisë dhe/ose prokurorisë publike;
- Janë bërë shumë pak përpjekje për masat parandaluese duke përfshirë edhe edukimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes në publik, sidomos ndërmjet nxënësve dhe popullatës të re duke patur parasysh se një pjesë domethënëse e viktimave dhe kryerësve janë të mitur apo persona të rinj;
- Me atë që fenomeni i veprave nga urrejtja nuk trajtohet si çështje e ndarë, shteti nuk ofron mbrojtje të veçantë dhe mbështetje për viktimat; dhe
- Pas ndryshimeve të miratuara në Kodin Penal në raport me veprat nga urrejtja, është vërejtur rritje e incidenteve të regjistruara zyrtarisht nga ana e MPB-së.

6. REKOMANDIME

1. Të sigurohet një hetim i shpejtë, i përditësuar dhe efektiv dhe ndjekje e veprave nga urrejtja duke garantuar që motivet e anshme janë marrë parasysh edhe gjatë procedurës penale;
2. Të ndërmerren masa përkatëse që të ndihmohet paraqitja e veprave nga urrejtja nga ana e viktimave, duke përfshirë edhe masat që të ndërtohet besimi në polici dhe në institucionet tjera shtetërore;
3. Të grumbullohen dhe publikohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe krahasuese për veprat nga urrejtja, sa që është e mundur më shumë duke përfshirë edhe numrin e incidenteve të tilla të paraqitura nga publiku dhe të evidentuara nga ana e organeve për zbatimin e ligjit; numri i dënimeve; motivet e anshme pas atyre veprave penale; dhe dënimet e shqiptuara ndaj kryerësve;
4. Të sigurohet se viktimat e veprave nga urrejtja janë të mbrojtur dhe të mbështetur;
5. Të avancohet trajnimi i praktikantëve relevant të cilët vijnë në kontakt me viktimat e veprave nga urrejtja, dhe ndërkohë duke ju mundësuar që në mënyrë efektive tu ndihmojnë këtyre viktimave; dhe
6. Të përforcohen masat parandaluese, mes tjerash edhe përmes reflektimit të edukimit për të drejtat e njeriut, planprogramet për histori dhe trajnimet relevante, ndërmarrja e hapave për edukimin e publikut, e sidomos fëmijëve dhe personave të rinj për vlerat e shumëllojshmërisë kulturore dhe gjithëpërfshirjes, me qëllim që të gjithë sektorët shoqërorë të kenë rol të caktuar në luftën kundër jotolerancës të tillë.

ANEKSI

INCIDENTE TË KRIMEVE NGA URREJTJA PËR VITIN 2019

1. Sulmohet i mituri në rrugën “Fushata e shkurtit”

Çfarë ka ndodhur: Në datën 10.01.2019 në ora 15.05 SPB Shkup, N.M. (19) nga Shkupi ka paraqitur se të njëjtën ditë rreth orës 15.00 në rrugën „Fushata e shkurtit“ vllau i tij i mitur është sulmuar fizikisht nga një person. Punohet në zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 janar viti 2019, në ora 15.00, rruga “Fushata e Shkurtit” Shkup.

Burimi i informacioneve: buletini ditor i MPB-së

Viktima të involvuara: një viktimë e mitur

Lloji i krimit: Dhunë (Neni 386, KP i RMV-së)

Kryerës: një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident që ka ndodhur, motivi i anshëm është origjina etnike, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. *Origjina etnike* – viktimat dhe sulmuesi ishin nga bashkësi të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: i panjohur

Përgjigje e institucioneve lokale: Nuk ka vërtetim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi mbi viktimën dhe komunitetin: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

2. Të mitur të sulmuar afër ndalesës të autobusit tek Qendra Vero

Çfarë ka ndodhur: R.S. (49) nga Shkupi ka paraqitur se në datë 13.01.2019 rreth orës 22,10 në bulevardin „Kuzman Josifovski - Pitu“ tre persona kanë sulmuar fizikisht djalin e tij dhe shokun e tij. Ndërmerren masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: data 13.01.2019 rreth orës 22,10 në bulevardin „Kuzman Josifovski-Pitu“ Shkup.

Burimi i informacionit: buletini ditor i MPB-së

Viktima të involvuara: dy viktimat të mitura

Lloji i krimit: Dhuna (neni 386, KP i RMV-së)

Kryerës: tre (3) kryerës të panjohur

Ky përshkrim i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident i cila ka ndodhur, motivi i anshëm është origjina etnike, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. *Origjina etnike* – viktimat dhe sulmuesit kanë qënë nga bashkësi të ndryshme etnike.
2. *Lokacioni* – Ky është lokacion në qendër të Qytetit të Shkupit në afërsi të qendrës Transportuese dhe qendrës Vero ku ka shumë ndalesa për autobus për transport lokal dhe ku kryqëzohen shumë linja dhe lidhin pjesë të qytetit të banuara me bashkësi të ndryshme etnike, dhe kështu është edhe vend ku perzihen shumë persona me origjinë të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: I panjohur

Përgjigje e institucioneve lokale: Nuk ka vërtetim për indikatorët e MPB-së për këtë incident

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

3. Krim kibernetik nga urrejtja

Çfarë ka ndodhur: Sektori për punë të brendshme Manastir dhe Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë Ministrisë të punëve të brendshme në koordinim me Prokurorinë themelore publike – Manastir kanë ndërmarrë masa dhe aktivitete për shkak të shpalljes të ndarë në rrjetin social Facebook ku ka kërcënim për jetën nga ana e O.J. (40) nga Manastiri, respektivisht për shkak të dyshimit të bazuar për vepër penale të kryer sipas nenit 144 „Rrezikimi i sigurisë” nga Kodi Penal i Republikës të Maqedonisë së Veriut.

Në datë 14.01.2019 personi O.J. është thirrur në bisedë zyrtare në stacionin policor, dhe janë marrë sende me qëllim që të sigurohen dëshmi.

Në datë 28.01.2019 deri të PTHP Manastir është dorëzuar kallëzim penal kundër O.J (40) nga Manastiri për vepër penale të kryer „rrezikimi i sigurisë “ nga neni 144 paragrafi 4 i KP të RMV-së. MPB e ka kualifikuar këtë vepër penale si vepër penale nga urrejtja.

Data, koha dhe vendi i incidentit: data dhe koha e pacaktuar, përmes rrjetit social Facebook,

Burimi i informacioneve: buletini ditor të MPB-së

Viktima të involvuara: e pacaktuar

Lloji i krimit: Rrezikimi i sigurisë (neni 144 paragrafi 4, KP i RMV-së)

Kryerës: një kryerës i identifikuar (O.J 40).

Përshkrim i shkurtër me indikatorë të anshëm: Në këtë incident i cili ka ndodhur, motivi i anshëm është origjina etnike, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Origjina etnike* – përhapja e fjalimit të urrejtjes dhe thirrja dhe nxitja e dhunës përmes mediave sociale kundër bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – thirrja dhe përhapja e urrejtjes etnike dhe thirrja për dhunë përmes mediave sociale është gjithnjë e më shpesh mënyra e kryerjes të veprave nga urrejtja.

Statusi i rastit: Kryerësi i identifikuar, është ngritur kallzim penal.

Përgjigje e institucioneve lokale: Është ngritur kallzimi penal përkatës për veprën penale të theksuar (neni 144 Rrezikimi i sigurisë). Vepra penale është kualifikuar si vepër nga urrejtja.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidente të këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

4. Sulmi i dy personave në rrugën Pero Nakov

Çfarë ka ndodhur: Në datën 14.01.2019 në ora 13.50 në SPB Shkup, D.K (24) nga fshati Crkvinjë, e Velesit, ka paraqitur se të njëjtën ditë rreth orës 13.20 në rrugën „Pero Nakov “ ai dhe vëllai i tij E.K janë sulmuar fizikisht nga dy persona, prej të cilëve, njëri ka patur thikë. Merren masa për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14.01.2019 në ora 13.20, rruga. Pero Nakov Shkup.

Burimi i informacioneve: buletini ditor i MPB-së

Viktimat e involvuara: dy viktima

Lloji i krimit: Dhuna (Neni 386, KP të RMV-së)

Kryerës: dy kryerës të panjohur.

Përshkrimi i shkurtër me indikatorë të anshëm: Në këtë incident që ka ndodhur, motivi i anshëm është origjina etnike, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – përhapja e gjuhës të urrejtjes dhe thirrja dhe nxitja e dhunës përmes mediave sociale kundër bashkësive të ndryshme etnike.
2. *Lokacioni* – në atë pjesë të qytetit ka strukturë të përzier etnike.

Statusi i rastit: i panjohur

Përgjigje e institucioneve lokale: Nuk ka vërtetim nga MPB për indikatorët për veprën nga urrejtja.

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

5. Kërcënime për deputetët përmes rrjetit social Facebook

Çfarë ka ndodhur: Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë Ministrisë të punëve të brendshme në koordinim me Prokurorinë themelore publike – Kumanovë, ka ndërmarrë masa dhe aktivitete për shkak të shpalljes të ndarë në rrjetin social Facebook nga ana e A.B (36) nga Kumanova, me çrast ka shkaktuar rrezikim të sigurisë të deputetëve në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe për shkak të shpërndarjes të materialit racist dhe ksenofobik përmes të sistemit kompjuterik respektivisht për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprës penale nga neni 144 „Rrezikimi i sigurisë “ dhe sipas neni 394-g „Shpërndarja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik“ nga Kodi Penal i Republikës të Maqedonisë së Veriut.

Pas urdhrorit të Prokurorisë themelore publike – Kumanovë, A.B. në datë **15.1.2019** është thirrur në bisedë zyrtare në stacionin policor, kurse janë marrë edhe objekte me qëllim të grumbullimit të dëshmive. Pas dokumentimit të rastit, kundër personit A.B. do të paraqitet kallzim penal.

Data, koha dhe vendi i incidentit: data dhe koha është caktuar saktë, përmes rrjetit social Facebook, MBR ka paraqitur kallzim penal në datë 15.01.2019

Burimi i informacioneve: buletini ditor i MPB-së

Viktimat e involvuara: të pacaktuara

Lloji i krimeve: Rrezikimi i sigurisë (neni 144 paragrafi 4, KP i RMV-së) Shpërndarja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik (Neni 394 – g KP i RMV-së)

Kryerësit: Një kryerës i identifikuar (A.B.36).

Përshkrimi i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident të ndodhur, motivi i anshëm është përkatësia politike, kurse indikatorët e anshëm janë:

1. *Modeli i incidenteve paraprake* – thirrja dhe shpërndarja e urrejtjes etnike dhe thirrja e dhunës përmes rrjeteve sociale është gjithnjë e më shpesh mënyra më e shpeshtë e kryerjes të veprave të urrejtjes.

Statusi i rastit: Është paraqitur kallzim penal. Vepra është kualifikuar si vepër penale nga urrejtja.

Përgjigje e institucioneve lokale: Është dorëzuar kallzim penal përkatës për veprën penale të theksuar (neni 144 Rrezikimi i sigurisë dhe neni 394-g Shpërndarja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik). Vepra është kualifikuar si vepër penale nga urrejtja.

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidentet e këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe stabilitetin politik në vend.

6. Sulm ndaj të miturve në afërsi të Stacionit Hekurudhor

Çfarë ka ndodhur: Në datën 16.01.2019 në orën 23.20 në Stacionin policor Qendër, B.I. (52) nga Shkupi ka paraqitur se të njëjtën ditë reth orës 22.30 në bulevardin „Kuzman Josifovski-Pitu” janë sulmuar fizikisht dy meshkuj të moshës nga 16 vjet nga disa persona.

Data, koha dhe vendi i incidentit: Data 16.01.2019 në ora 22:30 në bulevardin „Kuzman Josifovski – Pitu” Shkup.

Burimi i informacioneve: buletini ditor i MPB-së

Viktimat e involvuara: dy viktimat të mitura

Lloji i krimeve: Dhuna (Neni 386, KP i RMV-së)

Kryerës: disa kryerës të panjohur.

Përshkrimi i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident i cili ka ndodhur, motivi i anshëm është prejardhja etnike, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. *Prejardhja etnike* – viktimat dhe sulmuesit kanë qënë nga bashkësi të ndryshme etnike.
2. *Lokacioni* – ky është lokacion në qendër të Qytetit të Shkupit në afërsi të Qendrës Transportuese dhe qendrës Vero ku ka shumë ndalesa të autobusit për transport lokal dhe ku kryqëzohen shumë linja të cilat lidhin pjesë të qytetit të banuara me bashkësi të ndryshme etnike, e kështu është edhe vend ku përzihen shumë persona me prejardhje të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Nga ana e SP Qendër është marrë procesverbali për pranimit të kallzimit sipas nenit 12 LKRQRMV dhe ndërmerren masa për zbardhjen e sulmit fizik.

Përgjigje e institucioneve lokale: Nuk ka vërtetim për indikatorët nga MPB për këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidente të këtij lloji e sjellin në pyetje gjendjen e sigurisë të përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

7. Sulmi në NQP numër 5 për shkak të orientimit seksual

Çfarë ka ndodhur: Në datën 17.01.2019 në ora 11.50 në Stacionin policor Qendër, D.B. (26) nga Shkupi ka paraqitur se në datë 12.02.2019 reth orës 14.00 në autobusin e NQP numër 5 në Shkup në rrugën „Mitropolit Teodosij Gologanov” është sulmuar fizikisht nga një person i panjohur. Ndërmerren masa për zbardhje të tërësishme të rastit.

(Shënim: ky rast është paraqitur në stacionin policor pasi viktimat është drejtuar në Komitetin e Helsinkut për dhunë të kryer në autobus vetëm për shkak të orientimit të tij seksual)

Data, koha dhe vendi i incidentit: Data 12.01.2019 reth orës 14.00 në autobus të NQP në Shkup në rrugën „Mitropolit Teodosij Gologanov”

Burimi i informacioneve: është paraqitur kërkesë për NJPP në Komitetin e Helsinkut, buletini ditor i MPB

Viktimat e involvuara: një viktimë

Lloji i krimeve: Dhuna (Neni 385, KP i RM-së)

Kryerës: një kryerës i panjohur.

Përshkrimi i shkurtër i incidentit me indikatorë të anshëm: Në këtë incident i cili ka ndodhur, motivi i anshëm është orientimi seksual, ndërsa indikatorët e anshëm janë:

1. *Orientimi seksua l* – viktimat është identifikuar nga kryerësi si person LGBTI dhe prandaj është sulmuar.
2. *Lokacioni* – autobusët e transportit të qytetit shpesh janë vende ku kryhet dhunë nga urrejtja, kurse linja nr. 5 është një nga linjat më të shpeshta ku regjistrohen incidente nga dhuna.

3. *Modeli i incidenteve paraprahe* – sulmet e kryera për shkak të paragjykimeve që lidhen me pamjen dhe komunikimin e viktimës janë model i vërejtur edhe më parë te incidentet e kryera për shkak të orientimit seksual të viktimave.

Statusi i rastit: i panjohur

Përgjigje e institucioneve lokale: edhe pse rasti është paraqitur në stacionin policor Qendër, kryerësi ende nuk është identifikuar. Gjatë paraqitjes në stacionin policor, rasti është kualifikuar si kundravajtje, dhe jo si vepër penale.

Ndikimi mbi viktimat dhe komunitetin: Incidente të këtij lloji e sjellin në pyetje sigurinë e personave nga komuniteti LGBTI.

8. Sulme ndaj deputetët përmes Facebookut

